Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS - KOREKTIVNA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE
Njësia org/Org.Jedinica/Org Unit:
Nr./Br./No: 1314 Data/Datum/Date: 31.10.2023
PRISHTINË

# PLANI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2024

Me qëllim të ngritjes së nivelit të përformancës së Shërbimi Korrektues në këtë plan janë përfshirë aktivitetet të ndryshme siç janë: kompletimi i infrastrukturës Ligjore për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, trajtimi dhe risocializimi i personave të privuar nga liria, aktivitete lidhur me sigurinë dhe operativen, ngritjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e njësisë ekonomike, planifikimin e projekteve kapitale dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Shërbimi Korrektuese i Kosovës është në fazë zhvillimi të kapaciteteve të gjithmbarshme, andaj duke qenë të vetëdijshëm për detyrat tona specifike që janë të ndërlidhura me zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi, me theks të posaçëm me personat që kanë rënë ndesh me ligjin, synojmë të demonstrojmë përkushtim maksimal në menaxhimin e institucioneve korrektuese, ku dominon ligji dhe respektohen liritë dhe të Drejtat e Njeriut duke garantuar siguri juridike për subjektet e së drejtës dhe rritë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Planifikimi ka për qëllim të përcaktoj drejtimet e zhvillimit të SHKK-së në periudhën vjetore 2024, ky plan do të shërbej si orientim për përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të cilat i ka planifikuar. Një nga përpjekjet më serioze dhe me prioritet, e cila do të ndikon në riintigrimin dhe risocializimin e personave të dënuar do të jetë zhvillimi dhe reforma e një kulturë të re të punës dhe angazhimit me profesionalizëm për arritjen e efektivitetit ndërmjet resurseve dhe qëllimeve drejt një performancë të suksesshme të menaxhimit, organizimit, dhe mbikëqyrjes së ligjshmërisë në kuadër të fushëveprimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Do të përkushtohemi për bashkëpunim, që me punën tonë të fitojmë mbështetje të vazhdueshme nga partneret e drejtësisë penale si vendore dhe ndërkombëtare, për të realizuar misionin dhe rolin tonë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në institucione korrektuese, për të ofruar programe adekuate për të burgosur me qëllim rehabilitimit dhe risocializimin të suksesshëm për përgatitjen dhe ri integrimin e tyre në shoqëri, si dhe zvogëlimin e recidivizmit në të ardhmen.

Bazuar në gjithë këto, ne vlerësojmë se plani i përformancës do të jetë orientim për angazhimin e zyrtarëve të SHKK-së nga të gjitha institucionet korrektuese, departamentet, dhe njësit tjera, të cilat do te bëjnë një punë të jashtëzakonshme me qellim të përmbushjes së objektivave të SHKK-së .

SHKK ka trashëguar një gjendje të infrastrukturës jofunksionale, mirëpo është konsoliduar dhe është bërë funksionale, dhe ka plotësuar nevojat për mbajtjen e paraburgimit dhe të dënimeve që nga fillimi, duke ndryshuar pozitivisht deri në këtë fazë, ku janë arritur përparime të dukshme në infrastrukturë dhe ngritjen e nivelit të cilësisë së punës.

Shërbimi Korrektues i Kosovës që nga themelimi është pjesë e zhvillimeve të përgjithshme të rrethanave dhe ka kaluar nëpër sfida dhe vështirësi të ndryshme gjatë gjithë fazës së tranzicionit, por megjithatë SHKK ka arritur progres të dukshëm në përmbushjen e misionit dhe është duke vazhduar rrugën e zhvillimit të mëtutjeshëm sipas standardeve ndërkombëtare.

## Institucionet Korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës si Agjenci Ekzekutive e Sigurisë, në administrimin e saj aktualisht ka njëmbëdhjetë (11) Institucione Korrektuese si në vijim:

1. Qendra Korrektuese Dubravë;
2. Qendra Korrektuese Smrekonicë;
3. Qendra Korrektuese për të Mitur Lipjan;
4. Qendrën Edukativo -Korrektuese Lipjan;
5. Qendra Korrektuese për Femra Lipjan;
6. Qendrën e Paraburgimit Prizren;
7. Qendrën e Paraburgimit Prishtinë;
8. Qendrën e Paraburgimit Gjilan;
9. Qendrën e Paraburgimit Pejë;
10. Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë;
11. Burgu i Sigurisë së Lartë.

# Misioni

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit, duke respektuar të drejtat e tyre fondamentalë, garanton një ambient të sigurt për stafin dhe të burgosurit, si dhe kontribuon në sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

# Mandati i Shërbimit Korrektues të Kosovës

Mandati i Shërbimit Korrektues të Kosovës është përkufizuar me aktet ligjore përkatëse në fuqi. Sipas Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, SHKK është Agjenci Ekzekutive e Sigurisë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe është e pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.

## FUSHËVEPRIMI

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm;
- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese/korrektuese ,përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;
- Hartimi i programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe me burgim të përjetshëm;
- Vlerësimin e rrezikut kriminogjen për caktimin e nevojave për trajtim të kryerësve të veprave penale;
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- Ndërmarrjen e masave me qëllim të arsimimit dhe aftësimit profesional të personelit civil dhe të zyrtarëve korrektues të punësuar;
- Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat merren e çështjen e monitorimit e të drejtave te të burgosurve;

# Vizioni

Krijimi dhe zhvillimi i një Shërbimi Korrektues të avancuar, i cili do të funksionojë në përputhje me ligjin, normat dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare.

SHKK dhe institucionet korrektues, ku të burgosurit mbajnë dënimin, pasqyrojnë disa vlera demokratike të shoqërisë pjesë e se cilës jemi.

# Synimet

Duke qenë të vetëdijshëm për detyrat tona specifike dhe madhore, synimet tona janë të ndërlidhura edhe me zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi, besojmë se roli dhe synimet tona të arritura në të kaluarën dhe në të ardhmen do të jenë fundamentale për një shoqëri ku dominon ligji dhe respektohen liritë dhe të drejtat e të gjithëve.

Ne synojmë që përmes planifikimit të zbatojmë një organizim dhe menaxhim, i cili:

- Garanton menaxhimin profesional të vazhdueshëm të institucioneve korrektuese sipas standardeve më të larta që janë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Lehtëson qasjen në realizimin e të drejtave përmes një komunikimi të mirë mes të burgosurve dhe stafit që mbikëqyrin, ofrojnë shërbime dhe trajtim për risocializimin e të burgosurve dhe përgatitjen e tyre për jetë në liri.

Synimet kryesore të reformës në fushën e ekzekutimit të sanksioneve penale, përfshijnë rishikimin e kornizës ligjore dhe akteve nënligjore, forcimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve normative, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve më të mira për të burgosurit, angazhim në procesin arsimor, aftësimin profesional dhe avancimin e trajtimeve me qëllim të ri-socializimit të burgosurve.
Ngritja dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore, si dhe përmirësimi i kushteve të punës për stafin e SHKK-së.
Cilësia e menaxhimit të burgjeve varet shumë në saktësinë e pajtueshmërisë me rregullat dhe proceset e punës specifike, si dhe saktësinë e kontrollit dhe vlerësimit, prandaj, instrumentet, mekanizmat dhe procedurat do të përshtaten në mënyrë që të kontrollojnë saktësinë e të gjitha strukturave dhe proceseve me transparencë të plotë.

Funksionalizimi dhe zhvillimi i sistemit të avancuar të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave, si dhe klasifikimi i të burgosurve sipas standardeve më të avancuara për të arritur një rehabilitim të suksesshëm dhe përgatitje për lirim të të burgosurve. Klasifikimi do të bëhet sipas vlerësimit të rrezikut dhe nevojave.

Të burgosurit të cilët vlerësohen se paraqesin rrezik të ultë, duhet të ndahen nga ata të burgosur të cilët vlerësohen si të burgosur me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë, duke krijuar në këtë mënyrë tretmanë adekuat për trajtimin e tyre.

# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

- ✓ SIGURIMI I NJË MJEDISI TË SIGURT PËR TË GJITHË;
- ✓ PROMOVIMI I RISOCIALIZIMIT DHE REHABILITIMIT NËPËRMJET TRAJTIMIT TË TË BURGOSURVE DHE TË PARABURGOSURVE;
- ✓ NGRITJA E KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJRËZORE
- ✓ DRAFTIMI DHE ARRITJA E MARRËVESHJES ME SHTETIN E DANIMARKËS PËR LEJIMIN E SHFRYTËZIMIT TË MJEDISEVE TË QP GJILAN PËR 300 TË DËNUAR

## SIGURIMI I NJË MJEDISI TË SIGURT PËR TË GJITHË

| Objektivi 1 | Sigurimi i një mjedisi të sigurt për të gjithë | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivat specifike | | Afati | Njësia përgjegjëse | Institucionet e ndërlidhura | Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm (OVI) | Kostoja dhe burimet | Supozimet dhe rreziqet |
| 1.1 | Kapacitetet infrastrukturore | | | | | | |
| 1.1.1 | Fillimi i projektit (faza e parë) për ndërtimin e objekti të ri për të zëvendësuar dy qendrat aktuale të paraburgimit në Prizren/Pejë | Dhjetor | Divizioni i Inxheniering ur/ Prokurimi/ | Qeveria / Ministria e Financave / | Faza 1 e përfunduar | 450000 .00 € | Mungesa e buxhetit, dinamika e punës |
| 1.1.2 | Fillimi i projektit ( faza e parë ) për ndërtimin QK për femra në Lipjan dhe objektet përcjellëse | Dhjetor | Divizioni i Inxheniering ur/ Prokurimi/ | Qeveria / Ministria e Financave / | Faza 1 e përfunduar | 400000.0 0€ | Mungesa e buxhetit, dinamika e punës, stafi |
| 1.1.3 | Renovimi i kulmit te Teatrit ne | Nëntor | QK Dubravë/ | Qeveria / Ministria e | E rinovuar | 55,000€ | Dinamika e |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | QK Dubrave | | Divizioni i Inxheniering ur/ Prokurimi/ | Financave | | | punës, |
| 1.1.4 | Faza e dyte e projektit ndërtimit te shtëpive për nëna ne QK Lipjan | Dhjetor | QKF Lipjan / Divizioni i Inxheniering ur/ Prokurimi | Qeveria / MF / donatorë të tjerë | Objekti funksional | | dinamika e punës |
| 1.1.5 | Blerja e automjeteve për njësinë e transportit të burgosurve dhe institucionet e tjera korrektuese | 2024 | Departament i i sigurimit dhe operatives/ prokurimi | Qeveria / MF / donatorë të tjerë | Numri i automjeteve të blera | 100,000.0 0€ | Mungesa e buxhetit. |
| 1.1.6 | Avancimi i përdorimit të elementeve të sigurisë dinamike | | | | | | |
| 1.1.7 | Rritja e inspektimit të planifikuar dhe të jashtëzakonshëm | | Departament i i Sigurisë | Drejtoria e Përgjithshme | 20 inspektime te realizuara | Kosto administr ative | Rreziqet e paparashikueshm e të sigurisë dinamike dhe fizike |
| 1.1.8 | Çështjet ligjore dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.9 | Rritja e bashkëpunimit me KGJK-në, QKUK-në dhe agjenci të tjera të jashtme përmes memorandumit të mirëkuptimit dhe protokolleve për shkëmbimin e informacionit | 2024 | Departament i Ligjor | MD/ KGJK/ QKUK/ Policia | Marrëveshje e rishikuar me IPFK, Marrëveshje e rishikuar me SHSKUK-në | Kosto administr ative | Zbatimi i marrëveshjes<br>Ndryshimet në menaxhim dhe prioritetet e institucioneve të tjera |
| 1.1.10 | Shqyrtimi i kritereve të rekrutimit të stafit | Qershor 2024 | Departament i Ligjor | MD/Kuvendi | Inicimi i plotësim ndryshimit te ligjit për SHKK | Kosto administr ative | Numër i vogël aplikimeve |
| 1.1.11 | Hartimi i procedurave dhe rregullave te brendshme per NJVKB | Maj 2024 | Departament i Ligjor, NJVKB, | Eulex, INL | Rregullat e miratuara | Kosto administr ative | |
| 1.1.12 | Hartimi i procedurave dhe rregullave te brendshme për Njësinë e transportin e të burgosurve | Prill 2024 | Departament i Ligjor, NJPB, | Eulex, INL | Rregullat e miratuara | Kosto administr ative | |
| 1.1.13 | Hartimi i procedurave dhe rregullave te brendshme për Njësinë e Inteligjencës Korrektuese | Qershor 2024 | Departament i Ligjor, NJPB, | Eulex,ICITAP | Rregullat e miratuara | Kosto administr ative | |

## PROMOVIMI I RISOCIALIZIMIT DHE REHABILITIMIT NËPËRMJET TRAJTIMIT TË TË BURGOSURVE DHE TË PARABURGOSURVE

| Objektivi 2 | | Promovimi i risocializimit dhe rehabilitimit nëpërmjet trajtimit të të burgosurve dhe të paraburgosurve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivat specifike | | Afati | Njësia përgjegjëse | Institucionet e ndërlidhura | Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm (OVI) | Kostoja dhe burimet | Supozimet dhe rreziqet |
| 2.1 | Zbatimi i programeve | | | | | | |
| 2.1.1 | Hartimi i programeve të reja | Shtator | Departamenti për trajtimin e të burgosurve | Universitete/ OJQ/organizata ndërkombëtare/ambasada | Dy program rehabilituese të hartuar | Kosto administrative | Kapacitete të brendshme<br>Niveli i ulët i interesit nga partnerët dhe homologët |
| 2.1.2 | Hartimi i planit individual të dënimit për të gjithë të dënuarit e pranuar | Dhjetor | Njësia për vlerësim dhe | Institucionet Korrektuese | Planeve individuale të hartuara | Kosto administrativ | Kapacitete të |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | klasifikim/ Institucionet Korrektuese | | për te dënuarit e pranuar | e | brendshme |
| 2.1.3 | Rishikimi i memorandumeve të mirëkuptimit me partnerët përkatës për ofrimin e programeve rehabilituese | Dhjetor | Departamenti për trajtimin e të burgosurve / Departamenti Ligjor | Drejtor i Përgjithshëm / OJQ | Rishikimi i memorandumit me OJQ SIT, rishikimi i memorandumit me OJQ Bardha, rishikimi i memorandumit me Kryqin e Kuq të Kosovës | Kosto administrative | Mungesa e programeve adekuate<br>Interesi i partnerëve |
| 2.1.4 | Rritja e numrit të të burgosurve në programet e aftësimit profesional | Dhjetor | Institucionet Korrektuese / Departamenti për trajtimin e të burgosurve | MFPT/QAP/ OJQ | 115 të burgosurve të certifikuar | Kosto administrative | Mungesa e programeve adekuate |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.5 | Trajnimi i stafit për ofrimin e programeve rehabilituese për personat e dënuar | Dhjetor | Institucionet Korrektuese | Departamenti për trajtim | 40 anëtar stafit të trajnuar | Kosto administrative | Mungesa e kapaciteteve trajnuese |
| 2.1.6 | Arritja e marrëveshjeve me operatorët ekonomikë për krijimin e vendeve të punës brenda institucioneve korrektuese | Dhjetor | Njësia Ekonomike | OE | Një marrëveshje e arritur | // | Mungesa e interesit të kompanive |
| 2.1.7 | Rritja e mundësive të punësimit jashtë institucioneve korrektuese për të dënuarit | Dhjetor | Njësia Ekonomike | OE | 35 numri i të burgosurve të punësuar jashtë institucionit | // | Mungesa e interesit të kompanive |
| 2.1.8 | Shqyrtimi i udhëzimit për mekanizmin e ankesave | Shtator | Departamenti Ligjor | Këshilli i Evropës/ Avokati i Popullit/ OSBE/ EULEX | Udhëzuesi i rishikuar | Kosto administrative | Mungesa e besueshmërisë, Mungesa e transparencës |

# NGRITJA E KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE

| Objektivi 3 | | Ngritja e Kapaciteteve të Burimeve Njerëzore | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivat specifike | | Afati | Njësia përgjegjëse | Institucionet e ndërlidhura | Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm | Kostoja dhe burimet | Supozimet dhe rreziqet |
| 3.1 | Trajnimi | | | | | | |
| 3.1.1 | Zhvillo dhe realizo një program trajnimi për të gjithë stafin mbi sigurinë dinamike dhe modelimin pro-social | Shtator | Njësia e trajnimit | AKSP | Një programet e hartuara | Kosto administrative | Kapacitete të brendshme |
| 3.1.2 | Zhvillimi i vazhdueshëm profesional | Dhjetor | Njësia e trajnimit | AKSP | 150 zyrtar te trajnuar ne profile te ndryshme | Kosto administrative | Kapacitete të brendshme |
| 3.1.3 | Trajnimi i mbikëqyrësve për vlerësimin e stafit | 2024 | Njësia e Burimeve Njerëzore | Njësia e trajnimit | 20 Mbikëqyrës të trajnuar | Kosto administrative | Klimë jo të shëndetshme pune, ku |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | punonjësit nuk ndjehen të motivuar dhe nuk janë të kujdesshëm me detyrat e tyre |
| 3.1.4 | Fushatë informative e stafit për sinjalizim | 2024-2027 | Njësia e marrëdhënieve me publikun | Departamenti Ligjor/institucionet korrektuese | Numri i fushatave të realizuara | Kosto administrative | Mos raportimi i shkeljeve të ligjit, korrupsionit, keqbërjes, abuzimit me pushtet dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut |
| 3.1.5 | Rritja e numrit të punëtorëve socialë dhe zyrtarëve për trajtimin e të burgosurve | 2024-2027 | Njësia e Burimeve Njerëzore | MD/MFPT | 5 zyrtar te pranuar | 107,730.00€ | Mos aplikimi për shkak të pagës së ulët |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.6 | Zhvillimi i programit të mentorimit për zyrtarët e rinj (mbështetje nga kolegët) | 2024- | Njësia e trajnimit | Departamenti Ligjor/institucionet korrektuese | 70 Zyrtarë të rinj mentorohen | Kosto administrative | Hezitimi i stafit për të ofruar mbeshtetje. Përpilimi i programit adekuat |
| 3.1.7 | Rritja e numrit të instruktorëve të certifikuar për programet e aftësimit profesional | Dhjetor | Institucionet Korrektuese | Departamenti për trajtim / QAP | 5 stafit të trajnuar | Kosto administrative | Mungesa e kapaciteteve trajnuese |

## DRAFTIMI DHE ARRITJA E MARRËVESHJES ME SHTETIN E DANIMARKËS PËR LEJIMIN E SHFRYTËZIMIT TË MJEDISEVE TË QP GJILAN PËR 300 TË DËNUAR

| Objektivi 4 | | Zbatimi i marrëveshjes me shtetin e Danimarkës për lejimin e shfrytëzimit të mjediseve të QP Gjilan për 300 të dënuar | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Objektivat specifike | Afati | Njësia përgjegjëse | Institucionet e ndërlidhura | Treguesit Objektivisht të Verifikueshëm | Kostoja dhe burimet | Supozimet dhe rreziqet |
| 4.1 | Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes | Janar 2023 | SHKK / | MD/ Shërbimi Danez i Burgjeve | Marrëveshja është nënshkruar | 5 milionë<br>Transferim nga shteti danez | Mungesa e ekspertëve |
| 4.2 | Zhvillimi dhe hartimi i planit për transferimin e të burgosurve në Institucionet Korrektuese dhe lirimin e ambienteve të kësaj qendre | 2023 | SHKK / | MD | Lirimi i hapësirave për renovim | Kosto administrative | // |